



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DROPULL**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**  
Nr.           , Datë 30.06.2026

**“PËR MIRATIMIN TRANSFERIMEVE BUXHETORE, NË BUXHETIN E BASHKISË DROPULL PËR VITIN 2026”.**

Në mbështetje të nenit 54, pika “dh”, të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936,dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.66, datë 17.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Dropull”, i ndryshuar, në mbledhjen e datës 30.06.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratohen transferimet e shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Dropull për vitin 2026, si më poshtë:

**A. Të pakësohen shpenzimet:**

-Gr.00.Tit. 08220 .Kap.1. Art . 604 për 250.000 lek

**B. Të Shtohen shpenzimet:**

-Gr.00.Tit. 10430 .Kap.1. Art . 606 për 250.000 lek

2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

**KRYETAR**

**Donika BAUÇI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA DROPULL  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

**NR. DATË 30.06.2026**

**PËR  
“MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2027-2029, NË BASHKINË DROPULL”.**

Në mbështetje të nenit 41, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenit 4 dhe 27 të ligjit 9936, dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ; nenit 36 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Udhëzimeve të M.F.E., nr.23 dt.30.07.2018, “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJ.Q.V.”, i ndryshuar ; nr.07, datë 27.02.2026, “Për përgatitjen P.B.A Vendor 2027-2029, të njëjstëve të vetëqeverisjes vendore”; Vendimeve të K.B. nr.67, datë 17.12.2025, “Për miratimin e kalendarit të P.B.A 2027-2029”; Nr.08, datë 27.02.2026, “Për miratimin e Raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, në kuadër të përgatitjes së PBA 2027-2029”; Nr.14, datë.31.03.2026, “Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2027-2029”, Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr.02, datë 19.01.2026, “Për ngritjen e GMS dhe caktimin e EMP, në kuadër të përgatitjes së PBA 2027-2029”, Udhëzimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 01, datë 03.04.2026, “Për përgatitjen e P.B.A. 2027-2029”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbledhjen e datës 30.06.2026,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

1. Miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, në Bashkinë Dropull”, (bashkangjitur Dokumenti dhe raportet shoqëruese PBA1-PBA9)
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, ( sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015, ”Për Vetëqeverisjen Vendore”).

**KRYETAR  
Donika BAUÇI**





**BASHKIA DROPULL**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**



**BASHKIA DROPULL**

**DOKUMENTI I PARE I  
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
2027- 2029**

**Qershor 2026**

## 1. HYRJE.

### 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçar të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike.

Bashkia jonë është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike.

Bashkia ofron shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që jep ligji. Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektive të bashkisë me qëllimet strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të Bashkisë në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë trevjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë trevjeçare;
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe trevjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që Bashkia ndërmerr për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet , si dhe treguesit e performancës, informacion qe konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e Bashkisë, të cilat duhet të arrihen në një periudhë afatgjatë, si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një

Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e Bashkisë duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që Bashkia planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve të programit. Bashkia specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

**Udhëzimi Standart Nr.23 datë 23.07.2018, i PBA-së**, i ndryshuar, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore.

**Udhëzimi Nr.7, Datë 27/02/2026, “Për përgatitjen e PBA Vendor 2027-2029”**, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV, duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2027-2029, përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e Bashkisë, Këshillin, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve.
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e Bashkisë dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e shpenzimeve sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor).

**Faza e parë** e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga Bashkia për të realizuar alokimin strategjik të burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

## 2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Profili i Bashkisë.

Bashkia Dropull, është pjesë e Qarkut Gjirokastr dhe kufizohet në veri me bashkinë Libohovë, jug dhe juglindje me Republikën Helene, perëndim me bashkinë Finiq.

Kjo bashki përbëhet nga tre njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm me qendër fshatin Sofratikë, Dropull i Sipërm me qendër fshatin Vrisera dhe Pogon me qendër fshatin Polican. Të tri njësitë administrative kanë nën administrimin e tyre 41 fshatra.

Qendra e Bashkisë është fshati Jorgucat.

Sipas rregjistrimit të gjendjes civile, datë 01.01.2026, numëron 21.942 banorë, i ndarë sipas njësive administrative: Dropulli i Sipërm 9933 banorë, Dropull i Poshtëm 9081 banorë dhe Pogon 2928 banorë. Ndërsa, sipas censusit të vitit 2023, numri i popullsisë rezidente është 8259 banorë.

Bashkia Dropull shtrihet në një sipërfaqe prej 466.67 km<sup>2</sup>, me një densitet të popullsisë, prej 47 banorë/km<sup>2</sup>.

Bashkia e Dropullit përbëhet nga pjesëtarë të komunitetit etnik grek në Shqipëri.

Bashkia e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etno-kulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar ndër shekuj fillokseninë (mikpritjen), gjuhën, artin dhe qytetërimin helen, vallet e bukura, polifoninë, kostumet e pasura, motivet epirote të klarinetës, kishat dhe manastiret, sitet arkeologjike, arkitektoninë karakteristike, punimet e gurit, artizanatin, zejet, përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, gastronominë, etj.

Sipas regjistrimit statistikor të INSTAT, realizojnë aktivitetin e tyre në teritorin e Bashkisë Dropull 306 Ndermarrje, ku ato me status person juridik, zenë 12.8% të numrit total në rang Qarku, me status person fizik 6.1% dhe fermeret 4.9%.

Funksionojnë 4 (kater) kopshte publike fëmijësh dhe 2(dy) shkolla të mesme të bashkuara(publike), ku gjatë vitit shkollor 2025-2026, janë frekuentuar nga 45 femije në kopshte, 148 nxënës në arsimin 9-vjeçar dhe 78 nxënës në arsimin e mesëm.

Sipërfaqja e tokës së punueshme(bujqësore) është 8308.7 ha, prej së cilës kultivohet 2917 ha. Egzistojnë 213 ferma blegtorale dhe bujqësore, në të cilat mbarështohen 870 gjedhë, 12000 te imta, 23000 shpendë dhe 2800 koshere blete. Administron 19 rezervuarë ujëmbajtjes për vaditjen e kulturave bujqësore me kapacitet inventarizues 4441 ha, prej të cilave ujiten vetëm 502 ha. Është plotësuar me rrjet kanalesh kullues një sipërfaqe prej 5934 ha.

Bashkia Dropull administron një sipërfaqe kullimore prej 11508 ha, me kapacitet mbajtës, e ndarë në kullota verore për 16338 krerë te imta dhe kullota dimërore 7894 krerë. Po kështu disponon dhe administron një sipërfaqe pyjore prej 10.099 ha, që krahas të tjerave disponohet edhe për kullotë pyjore për 18.500 krerë. Për plotësimin me ujë të pijshëm të nevojave të blegtorisë janë në inventar 20 ujëmbledhës të vegjël malorë.

## 3. Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

**Rritja e aksesueshmërisë dhe integrimi territorial**, si në nivel makro dhe atë mikro, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së veprave infrastrukturore të artit, si urat, rrugët, përmirësimi i menaxhimit të reziqeve natyrore nëpërmjet shtimit të pyllëzimit, mbrojtjes së argjinaturave të lumenjve, sistemimit e pritave dhe përenjve etj.

**Integrimi në rajonin ekonomik ndërkufitar** përmes zhvillimit dhe diversifikimit të ekonomisë lokale, pjesëmarrjes në projekte evropiane ndërkufitare, afrimit dhe ndërtimit të aktiviteteve të përbashkëta, në interes të komunitetit dhe zhvillimit të turizmit.

**Ruajtja e karakterit rural të vendbanimeve**, promovimi i traditës, ruajtja e ekosistemit, mjedisit me synim përmirësimin e cilësisë dhe kushteve të jetesës të komunitetit.

**Mbrojtja e territorit, e peisazhit dhe habitateve natyrore**, si dhe rehabilitimi i veprave infrastrukturore, hartimi i planeve të mbrojtjes civile, menaxhimit të burimeve ujore në vaditjen e

kulturave bujqësore për përballimin e thatësirës gjatë periudhës së verës.

**Zhvillimin me prioritet të Turizmit**, promovimin e paketave lokale turistike në bashkëpunim me aktorë rajonalë dhe kufitarë, nxitjen dhe mbështetjen e bizneseve turistike, duke garantuar rritjen e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave shtesë, për rritjen e nivelit të shërbimeve vendore.

**Krijimin e kushteve për nxitjen e kthimit dhe riintegrimin e emigrantëve**, duke rritur sasinë dhe cilësinë e shërbimeve, krijimin e një mjedisi social miqësor, nxitjen dhe mbështetjen me projekte për punësim dhe biznes, përkrahjen e inisiativave të aktorëve shoqërorë për këtë qëllim, etj

**Garantimin e sigurisë publike**, rruajtjen nga vjedhjet dhe dëmtimet të pronës private e publike, mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, duke krijuar një klimë miqësore për biznesin, emigrantët dhe turizmin, sidomos kjo në zonat e thella në Njësitë Administrative Dropull i Sipërm dhe gjithë Njësinë Administrative Pogon.

**Të sigurojë kushte jetese dinjitoze për moshën e tretë dhe kujdesin social për individët dhe familjet në nevojë** nëpërmjet realizimit të objektivave kombëtarë për moshimin (ndërtimin e një Qendre Rezidenciale për të moshuar), mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë, akses në shërbimet e Bashkisë, sidomos në fshatrat e thella, si edhe aplikimit dhe përfitimit nga projektet kombëtare dhe evropiane për këtë qëllim.

**Përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së institucioneve arsimore, qendrave shëndetësore**, abulancave të fshatrave, kujdes shëndetësor me ekip të lëvizshëm, duke qenë se zonat banojnë nga mosha të mëdha, që kanë nevojë për asistencë dhe shërbime të vazhdueshme mjekësore. Zhvillimin e sektorit Parësor dhe profilaktik, nëpërmjet krijimit të 3 Qendrave për promovimin e shëndetit të komunitetit dhe shërbime parësore, diagnostifikuese, etj.

**Menaxhimi i mbetjeve urbane**, duke e shtrirë shërbimin në 100% të teritorit, duke krijuar kushte për riciklimin e tyre dhe venddepozitimin sipas standarteve më të përparuara, duke e kombinuar me politikat rajonale dhe kombëtare për këtë qëllim.

#### 4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË DROPULL 2027-2029

##### 4.1. Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Dropull për vitet 2027-2029

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi të ardhurat faktike të dy viteve të fundit, buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korrent dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Te ardhurat totale te Bashkise

Fakti 2024	Fakti 2025	Buxh Fillestar 2026	Pritshmi 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
298,580	368,473	448,077	517,699	344,725	337,495	350,265

Tabela më poshtë paraqet të ardhurat e Bashkisë sipas burimeve:

Ko di	Lloji	Fakt 2024	Fakt 2025	Buxh Fillestar 2026	Pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
A	Të ardhura nga burimet e veta	51,850	55,820	68,659	68,659	67,863	68,312	68,812
B	Të ardhura nga buxheti qendror	188,022	250,853	226,266	226,266	237,469	248,183	259,853
C	Te ardhura nga taksat e ndara	8,133	11,149	9,000	9,000	9,400	9,500	9,600
D	Grante he transferta te tjera (te huaja)	17,741	1,409	88,218	105,167	16,725	0	0
E	Trashëgimi nga viti i shkuar	32,834	49,241	55,934	108,606	13,298	11,500	12,000

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me të gjitha EMP, ku të dhenat nga secila Drejtori (EMP), të cilat krijojnë të ardhura për Bashkinë, duke iu referuar planifikimit vjetor 2026, realizimit të dy viteve paraardhese, që perben dhe bazen e perlllogaritjeve. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt

përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e Bashkisë.

Nga të dhënat e tabelës së mesiperme, shikohet se ka një qëndrueshmëri, në lidhje me të ardhurat e parashikuara, për vitet 2027-2029, si për ato nga burimet e veta dhe ato nga pushteti qendror. Në të ardhurat e planifikuara nga pushteti qendror për vitet 2027-2029, nuk janë përfshirë të ardhurat nga transfertat e kushtëzuar për projekte të veçanta nga Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore. Gjithashtu nuk kemi përfshirë të ardhurat që do vijojnë për funksionet e deleguara, si shërbimi i gjëndjes civile dhe pagesat për trajtimin e individëve në nevojë me Ndihmë Ekonomike dhe ato të aftësisë së kufizuar, të verbërit, paraplegjikët, invalidët e punës etj. Mos parashikimi i të ardhurave të mesiperme lidhet me faktin se ato parashikohen, paraqiten dhe monitorohen nga institucionet, që i dergojnë dhe dublimi i tyre shtremberon analizën dhe krahasimin e tyre.

Parashikimi i të ardhurave nga burimet e veta për këtë periudhë synon ruajtjen dhe rritjen graduale dhe të qëndrueshme të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore dhe të të ardhurave të tjera, në sajë të fokusimit tek zgjerimi i vazhdueshëm i bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal, por pa ndryshuar në përgjithësi nivelet e taksave dhe tarifave vendore, me përjashtim të disa tarifave si ato për ndricim rrugor, shërbime në varena, që kanë qenë dukshëm shumë larg nivelit të kostos së këtyre shërbimeve. Gjithashtu nuk kemi planifikuar vendosjen e taksave të perkohshme.

#### TABELA E TË ARDHURAVE NGA BURIMET E VETA, SIPAS LLOJIT

Në 000/lek

Tabela më poshtë paraqet TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA :Kodi	Lloji	Fakti 2024	Fakti 2025	Buxh Fillestar 2026	Pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
A.1	Taksa e pasurisë së paluajtshme	19,442	19,719	20,300	20,300	20,500	20,400	20,700
A.2	Taksa e ndikimit në infrastrukture	3,091	1,349	5,000	5,000	3,000	3,000	3,000
A.3	Taksa të tjera vendore	504	490	850	850	1,000	1,000	1,200
A.4	Tarifa vendore	26,306	25,655	29,852	29,852	30,532	30,812	30,812
A.5	Te ardhura nga asetet dhe aktiviteti ekonomik	1,420	7,548	12,427	12,427	11,831	12,100	12,100
A.6	Te tjera administrative	1,087	1,059	500	500	1,000	1,000	1,000

TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA parashikohen të ndryshojnë nga viti në vit respektivisht si më poshtë:

Ndryshimi në përqindje <i>Plan 2027 ndaj 2026</i> <b>-1.1%</b>	Ndryshimi në përqindje <i>Plan 2028 ndaj Plan 2027</i> <b>0.6%</b>	Ndryshimi në përqindje <i>Plan 2029 ndaj Plan 2028</i> <b>0.7%</b>
--	--	--

Kemi nje qendrueshmeri ne te ardhurat nga burimet e veta me nje rritje të vogël nga viti 2027, ne vitin 2029. 24500

#### *Planifikimi i Të ardhura nga taksa e pasurise se paluajtshme.*

Për vitin 2027, parashikohet që të ardhurat nga taksat e pasurise se paluajtshme (mbi ndertesën, mbi truallin dhe token bujqesore), të përbëjnë rreth 30,2% të të ardhurave nga burimet e veta të Bashkisë. Brenda te ardhurave nga taksa e pasurise se paluajtshme, taksa mbi ndertesën zë 48,3%, ajo per token bujqësore 38% dhe mbi truallin 12.6 %.

Planifikimi i të ardhurave nga taksa e pasurise se paluajtshme bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve te pronave te paluajtshme.
- nëpërmjet verifikimeve ne terren,
- përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit me institucionin e Agjensise Shteterore te Kadastres.

#### *Planifikimi i Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.*

Planifikimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit nne infrastrukturë me një ulje prej 6,3% në vitin 2027, në krahasim me vitin 2026, rezulton per shkak te mosrealizimit nder vite te ketij zeri.

Për vitet 2027-2029, të ardhurat e parashikuara për Bashkinë Dropull, nga taksat e ndikimit në infrastrukturë përbëjnë rreth 4.4,% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë dhe reformat në A.SH.K, brenda periudhës së PBA 2027-2029, do të krijohen kushtet për realizimin e të ardhurave nga kjo takse, e cila gjatë vitit 2025, u realizua në nivelet më të ulëta (1.349 mije lek).

#### *Planifikimi i Të ardhura nga taksat e tjera vendore.*

Këtu për Bashkinë tonë, përfshihen kryesisht, taksa vendore për shërbimin hotelier dhe taksa e Tabelës. Këto taksa përbëjnë rreth 1,4 % të të ardhurave nga burimet e veta. Mundësitë dhe rezervat nga ana jonë gjykohen për rritjen e të ardhurave për taksën e pare (sherb.hotelier) me mundësitë që krijon zhvillimi i turizmit të bujtinave, ku parashikojmë rritjen e te ardhurave për vitet 2027, 2028 dhe 2029. Ndërsa për taksën e tabelës të ardhurat parashikohen të qëndrueshme.

#### *1.4 Planifikimi i Të ardhurave nga tarifa vendore*

Për vitet 2027-2029, të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 45,1 % të të ardhurave nga burimet e veta te Bashkise. Brenda struktures së tarifave vendore, peshën më të madhe e zëne të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbetjeve, me 49,7 % të ardhurave nga tarifat vendore.

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi. Në funksion të

këtij citimi të fundit, të ardhurat nga të gjithë grup tarifave vendore paraqiten dhe planifikohen në mënyrë të qëndrueshme, me përjashtim të ndriçimit public dhe tarifa për shërbimet në vareza, për të cilat parashikojmë rritje të tarifës, për ti përfruar me koston e shërbimeve perkatese.

Tabela më poshtë paraqet detajimin e Të ardhura nga tarifa vendore :

Në 000/lek

Kodi	Lloji i te ardhurave	2024	2025	Buxheti fillestar 2026	I pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
A.4.1	Tarifa e menaxhimit te mbetjeve	12,710	14,342	15,082	15,082	15,182	15,212	15,212
A.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	2,522	3,792	4,200	4,200	4,200	4,200	4,200
A.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	8,685	5,348	2,900	2,900	3,000	3,000	3,000
A.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	1,102	860	1,500	1,500	2,200	2,500	2,500
A.4.11	Tarifa e parkimit	152	143	100	100	150	100	100
A.4.2	Tarifa per zenien e hapësirës publike	0	0	100	100	100	100	100
A.4.12	Tarifa të tjera	1,135	1,170	5,700	5,700	5,700	5,700	5,700

Të ardhura nga tarifa vendore në total parashikohen të ndryshojnë nga viti në vit respektivisht si më poshtë:

Ndryshimi në përqindje  
Plan 2027 ndaj plan 2026  
**3,2 %**

Ndryshimi në përqindje  
Plan 2028 ndaj Plan 2027  
**0,9 %**

Ndryshimi në përqindje  
Plan 2029 ndaj Plan 2028  
**0 %**

### ***1.5. Planifikimi i Të ardhurave nga asetet dhe aktiviteti ekonomik.***

Këtu përfshihen të ardhurat nga dhënia me qira të aseteve në pronësi të Bashkisë, ato nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, si dhe ato nga shitja e aseteve. Këto të ardhura, përbëjnë rreth 17.4% të të ardhurave nga burimet e veta në vitet 2027-2029. Me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë dhe reformat në A.SH.K, brenda periudhës së PBA 2027-2029, do të krijohen kushtet për rritjen e të ardhurave nga shitja e aseteve fikse te prekshme/paprekshme, që përbëjnë zërin kryesor të këtij grupi.

**Planifikimi i TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR për periudhën 2027-2029**

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së 2027-2029, për Transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme; transfertat e pakushtëzuara sektoriale; transfertat e kushtëzuara; të ardhurat nga taksat e ndara.

Tabela më poshtë paraqet TË ARDHURAT TOTALE NGA BUXHETI QENDROR :

Në 000/lek

Fakti 2024	Fakti 2025	Buxh Fillestar 2026	Pritshmi 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
188,022	250,853	226,266	226,266	237,439	248,183	259,853

TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR parashikohen të ndryshojnë nga viti në vit respektivisht si më poshtë:

Ndryshimi në përqindje  
Plan 2027 ndaj 2026  
**4,9 %**

Ndryshimi në përqindje  
Plan 2028 ndaj Plan 2027  
**4,5 %**

Ndryshimi në përqindje  
Plan 2029 ndaj Plan 2028  
**4,7 %**

Ndryshimi i madh në rritje tek viti 2026, në krahasim me të pritshmin e vitit 2025, ndodh për arsye se transfertat e pakushtëzuara sektoriale për vitin 2026, rriten në masën 116% në krahasim me vitin 2025, ndërsa vitet e tjera parashikohen konstante.

Tabela më poshtë paraqet TË ARDHURAT SIPAS LLOJIT NGA BUXHETI QENDROR :

Në 000/lek

Kodi	Lloji i të ardhurave	2024	2025	Buxheti fillestar 2026	I pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
1	Transferta e pakushtëzuar	133,996	191,879	167,310	167,310	177,304	188,048	199,117
2	Trasferta specifike	54,025	58,974	58,956	58,956	60,135	60,135	60,736
3	Taksat e ndara	8,133	11,149	9,000	9,000	9,400	9,500	9,600

*Planifikimi i Të ardhura nga taksat e ndara.*

Dy grupimet baze të kësaj kategorie janë ato për qarkullimin e mjeteve të përdorura dhe ato mbi të ardhurat personale, të cilat gjenerohen nga DPT, kurse dy zërat e tjerë janë në vlerë të papërfillshme. Të ardhurat nga taksat e ndara, në përgjithësi kanë tendencë qëndrueshmërie me prirje te vogla rritjeje.

Tabela më poshtë paraqet detajimin e Të ardhura nga taksat e ndara :

Në 000/lek

	Lloji i te ardhurave	2024	2025	Buxheti fillestar 2026	I pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4,597	4,631	4,200	4,200	4,600	4,600	4,600
A.2.3	Taksa e rentës minerare	0	1	0	0	0	0	0
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	3,536	6,517	4,800	4,800	4,800	4,900	5,000

***Planifikimi i Të ardhura nga grante të huaja, huamarrje dhe trashëgimi nga viti I kaluar.***

Ne parashikimin e te ardhurave, ne kuadër të PBA 2026-2028, planifikojmë dhe tri kategori të tjera të të ardhurave, që janë:

- Grante dhe transferta të tjera (të huaja)
- Huamarrja
- Trashëgimi nga viti i kaluar.

Tabela më poshtë paraqet TË ARDHURAT SIPAS LLOJEVE TË MËSIPËRME

Në 000/lek

Kodi	Lloji i te ardhurave	2024	2025	Buxheti fillestar 2026	I pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
1	Grante dhe transferta të tjera (të huaja)	17,741	1,409	88,218	105,167	16,725	0	0
2	Huamarrja	0	0	0	0	0	0	0

3	Trashëgimi nga viti i kaluar	32,834	49,241	55,934	108,606	13,298	11,500	12,000

#### 4.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Dropull për periudhën 2027-2029

Tabela 3, paraqet shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2024 deri në 2029.

*PBA3-. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas klasifikimit ekonomik. (shiko ne fund te projektdokumentit)*

**Totali i shpenzimeve për personelin** per vitin 2027 është planifikuar 202.511 mijë lekë dhe zë 58.75% të totalit të shpenzimeve. Per vitin 2028 është planifikuar 204.507 mijë lekë dhe zë 60.6% të totalit të shpenzimeve, per vitin 2029 është planifikuar 209.897 mijë lekë dhe zë 59.9% të totalit të shpenzimeve. Siç vërehet dhe nga shifrat më sipër, niveli i shpenzimeve për personelin për periudhën afatmesme 2027 – 2029, është i qëndrueshëm, me tendencë rritje të vogël, që lidhet përveç të tjerave edhe me rishikimin dhe harmonizimin me politikat kombëtare për rritjen e pagave të punonjësve. Ndërkohë, krahasuar me realizimin e pritshëm te vitit aktual 2026, shpenzimet për personelin për vitin 2027, vijnë me ulje në masën 0,5% . .

**Totali i shpenzimeve operative** dhe të mirëmbajtjes dhe transfertat (602-609) per vitin 2027, është planifikuar 77.227 mijë lek dhe zë 22,4% të totalit të shpenzimeve; per vitin 2028, është planifikuar 87.223 mijë lek dhe zë 25,85% të totalit të shpenzimeve; per vitin 2029, është planifikuar 96.047 mijë lek dhe zë 27,42% të totalit të shpenzimeve. Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe transfertat per individe, (602-609) për periudhën afatmesme 2027– 2029, janë në trend rritës ne mase absolute, dhe kjo përveç të tjerave lidhet me rritjen e cilësisë së shërbimeve, por edhe të inflacionit. Ndërkohë, krahasuar me realizimin e pritshëm të vitit aktual 2026, shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe transfertat per individe për vitin 2027, vijnë me ulje në masën 24%. Kjo e fundit pasi në këtë fazë të zbatimit të buxhetit të vitit 2026, kemi krijuar një tablo më të qartë të ecurisë së tyre. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë planifikuar kryesisht në programet buxhetore të mëposhtme:

- Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Menaxhimi i mbetjeve urbane
- Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi,
- Shërbime Publike,
- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile,
- Administrimi i pyjeve, kullotave, kullimit
- Mirëmbajtja e rrugëve rurale
- Shërbime kulturore

**Totali i shpenzimeve kapitale** per vitin 2027, është planifikuar 48.262 mijë lek dhe zë 14% të totalit të shpenzimeve; për vitin 2028, është planifikuar 45.745 mijë lek dhe zë 13.6% të totalit të shpenzimeve; per vitin 2029, është planifikuar 44.300 mijë lek dhe zë 12,7% të totalit të

shpenzimeve. Siç vërehet dhe nga shifrat e përmbledhura më sipër, niveli i investimeve kapitale për periudhën afatmesme 2027 – 2029, është në trend të qendrueshem, me prirje të vogël uljeje nga viti në vit. Kjo pikë së pari lidhet me politiken lokale të qendrueshme, por edhe me kategorite e tjera të shpenzimeve, që trajtuam më lart. Ndërkohë, krahasuar me realizimin e vitit aktual 2026, investimet kapitale për vitin 2027, janë në masën 63,2%. Investimet kryesore janë planifikuar në programet buxhetore të mëposhtme:

- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- Rrjeti rrugor rural,
- Sherbimet kulturore,
- Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi,
- Sherbimet Publike
- Kullimi dhe ujitja
- Strehimi social.

## **BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE**

Buxheti total i Bashkisë Dropull menaxhohet sipas 16 programeve të shpenzimeve. Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë.

Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve;
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Tabela 5, paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për dy vitet e mëparshme (faktin), vitin aktual buxhetor (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme të PBA-së (parashikimi).

*PBA5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike*

## 1. Programi 01110. Planifikim, Menaxhim, Administrim

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;</li> <li>• Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjete, zyrave të printimit dhe IT etj;</li> <li>• Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë;</li> <li>• Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;</li> <li>• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj;</li> <li>• Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;</li> <li>• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimi i fondeve të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore;</li> <li>• Amortizimi i huave të marra etj.</li> </ul>

**Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit**

Qëllimi i këtij Programi është përmirësimi i transparencës së punës në administratën e Bashkisë, të risë përgjegjshmërinë e saj, për të krijuar kushtet e nevojshme për shërbime cilësore ndaj

qytetarëve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre me iniciativa dhe rekomandime në ushtrimin e funksioneve të Bashkise. Kjo e fundit do të realizohet nëpërmjet objektivit të rëndësishëm të materializimit, pra të përfshirjes së këtyre iniciativave dhe propozimeve qytetare në vendimet e Këshillit Bashkiak, në Urdhërat e Kryetarit, si edhe në Rregulloret dhe veprimtaritë e tjera. Gjithashtu efikasiteti dhe transparenca në punën e administratës, që përkthehet në rritjen e shërbimeve ndaj qytetarit, ndaj komisioneve të Këshillit dhe Kryetarit, kërkon realizimin edhe të objektivit tjetër për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të administratës, rinovimin e vazhdueshëm rregulloreve, përmirësimin e etikës së komunikimit, rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit midis Drejtorive dhe Sektorëve me Kabinetin, Këshillin Bashkiak dhe Organet Rajonale dhe Qendrore.

*PBA 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit 01110 ( në SMBV)*

### **Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit**

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

*PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 01110 ( në SMBV)*

Te dhenat e totalit të shpenzimeve të këtij programi kanë një qendrueshmeri në vite. Kjo, krahas të tjerave tregon se stafi i Bashkise perballon aktivitetin e shërbimeve dhe të veprimtarive të saj në rritje, me të njëjten masë shpenzimesh, kjo në sajë të eksperiencës së fituar, por edhe trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm, si dhe rritjen e efektivitetit të shpenzimeve.

Të gjitha llojet e shpenzimeve, sipas kategorive ekonomike, paga-sigurime shoqërore, operative dhe kapitale, paraqiten të qëndrueshme, për të përballuar treguesit makroekonomikë fiskalë, siç janë inflacioni, kursi i këmbimit etj.

Kështu shpenzimet materiale, të cilat kryesisht konsistojnë në shërbime nga të tretët, si energji elektrike, ujë, shërbime interneti dhe telefonie; në shpenzime transporti, si ato për karburant, vaj lubrifikant, pjesë këmbimi, goma, bateri, siguracion të mjeteve, etj; në shpenzime materiale zyre dhe të përgjithshme; në shpenzime udhëtimi; mirëmbajtjeje, etj, kanë një rritje të papërfillshme nga viti në vit.

Po kështu edhe shpenzimet kapitale të këtij programi, përfaqësojnë një vlerë të vogël dhe konsistojnë në blerje dhe mirëmbajtje të inventarit ekonomik (kompjuter, printer, fotokopje, scanner, tavolinë zyre, karrige, etj).

Kështu shpenzimet kapitale në këtë program buxhetor përfaqësojnë mesatarisht 1,14% të totalit të shpenzimeve të programit, sipas viteve 2027-2029.

Brenda këtij programi, si zë me vetë, paraqiten shpenzimet të funksionimit të Këshillit të Bashkise dhe të komisioneve të tij, në rolin e tij përfaqësues, vendimarrës dhe mbikqyrës. Planifikimi i tyre u krye në bazë të planit të punës, planit të vendimarrjes, përshkrimit të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve të Këshillit gjatë 1 viti., në bashkëpunim me Sekretaren e Këshillit Bashkiak dhe projektin “Bashki të Forta”. Është një parashikim modest i shpenzimeve me të domosdoshme për funksionimin normal dhe mbështetjen e gjithë veprimtarisë së Këshillit Bashkiak, për vitin 2026 dhe vitet e PBA 2027-2029, që synojnë rritjen e rolit të tij dhe sidomos fuqizimin e transparencës së veprimtarisë së këtij organi, organizimin e seancave degjimore me komunitetin dhe grupet e interesit, etj. Realizimi dhe rritja e shpenzimeve të mesiperme do të rrisë gjithashtu rolin e

kryesive të fshatrave dhe të Kryetareve të tyre, në zbatim të kompetencave të tyre sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",.

Kështu shpenzimet për këtë produkt (akte të miratuara nga K.Bashkiak), kanë një qëndrueshmëri ndër vite, për të përballuar një numër aktivitete në rritje, me rezultat uljen e kostos së këtij produkti.

## 2. Programi 03140. Shërbimet policore.

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Masa të njësisë së vetëqeverisjes vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësia vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;</li> <li>• Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.</li> </ul>

Eshte nje program i ri per Bashkine, që u aplikua për herë të parë në vitin 2024, pasi vitet e mëparshme ka qene i inkuadruar ne Programin Buxhetor 01110 (Planifikim, Menaxhim, Administrim). Vendosja e objektivave dhe e treguesve te performances edhe per këtë program do të ndikojë në rritjen e nivelit të sigurisë për komunitetin, zgjidhjen e problemeve të përditshmërisë, si dhe zbatimin më të mirë të akteve të nxjerra nga Këshilli i Bashkisë dhe Kryetari.

Synimi do të jetë përmirësimi i sigurisë dhe qetësisë publike, si edhe mbarëvajtja e shërbimeve dhe e marrëdhënieve në komunitete, duke çuar në uljen e kundravajtjeve administrative nëpërmjet masave parandaluese, që janë inspektimet dhe të nje pranie më të shpeshtë të stafit të Policisë Bashkiake në fshatrat e Bashkisë, sidomos ato të largeta nga Qendra, duke u forcuar ndjenjen e sigurisë, shkëputjen nga vetmia të të moshuarve, etj.

Kjo do të arrihet nepermjet,

- Rritjes nga viti ne vit te patrullimeve javore
- Rritjes se inspektimeve mujore me nje plan tematik mujor te fokusuar ne vecorite dhe problematikat e cdo njesie administrative.

### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 03140 (në SMBV)*

Në shpenzimet e planifikuara për vitet e PBA 2027-2029, janë parashikuar shpenzimet për pagat e personelit, për trajnimin e punonjësve, si edhe ato për uniformat dhe shpenzimet e tjera korente (të mjetit të veçantë të Policisë Bashkiake). Gjatë dy viteve të fundit të PBA, parashikohet që numri i patrullimeve javore të rritet, për përmbushjen sa më mirë të objektivit të këtij Programi.

Shpenzimet e përgjithshme të këtij programi buxhetor kane nje qendrueshmeri ne vite, me nje rritje te paperfillshme, përkatësisht 1,3% për vitet e PBA 2027-2029.

### 3. Programi 03280: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe të mbrojtjes civile

Vështrim i përgjithshëm		
Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li> <li>• Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li> <li>• Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li> <li>• Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.</li> </ul>

Qëllimi i këtij programi është mbulimi me shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si edhe shërbimet e mbrojtjes civile në të gjithë teritorin të Bashkisë, në mënyrë sa më efektive dhe në kohë sa më të shpejtë. Kjo krahas të tjerave presupozon arritjen e ekipeve të mbrojtjes dhe shpëtimit në skajet më të largëta nga vendstacionimi i tyre. Kjo kërkon gadishmëri të lartë, logjistike dhe një organizim operacional.

Realizimi i qëllimit të mësipërm do të bëhet nëpërmjet objektivave dhe treguesve konkret, si përmirësimi i vazhdueshëm i efikasitetit të ndërhyrjeve për rastet e zjarrit dhe ndërhyrjeve për shpëtim, nëpërmjet rritjes së rasteve të ndërhyrjeve dhe aftësisë reaguese ndaj emergjencave, duke ulur kohën e reagimit.

Gjithashtu për vitet e PBA 2027-2029, dhe vitin e pritshëm buxhetor është programuar marrja e masave mbrojtëse papaprake, lidhur me mbështetjen logjistike të këtij Programi, që synojnë në pajisje dhe kostume zjarrduruese, si edhe nje mjet te ri zjarrfikës pergjate viteve te PBA 2027-2029. Po, kështu, ngritja e një pike shërbimi mbrojtje nga zjarri në Njësinë Administrative Pogon, duke e mbështetur me mjet zjarrfikës dhe një ekip operacional, është përparësi, pasi kjo Njësi, ka sipërfaqen gjeografike më të madhe në tërësi, por edhe atë pyjore, kullosore në veçanti.

Përveç gadishmërisë ditore të forcave të shpëtimit dhe zjarrfikësve, si edhe mjeteve, realizohen stërvitje në kushte reale, si edhe trajnimi i vazhdueshëm, si parakusht për ndërhyrje të efektshme në rastet e emergjencave, si ato të rënies së zjarreve, përmbytjeve të zonave të banimit dhe infrastrukturës rrugore, bllokimit të rrugëve, aksidenteve rrugore, etj.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 03280 (nëSMBV)*

Nga krahasimi i të dhënave ndër vite vërrehet rritja graduale e shpenzimeve për këtë program, si në krahasim me vitet e mëparshme 2024 dhe 2025, 2026, por, edhe gjate viteve 2027-2029.

Kështu, shpenzimet e përgjithshme në vitet 2028 dhe 2029, rriten përkatësisht 25, dhe 2.14%.(që i dedikohet kryesisht masave mbrojtëse). Kjo rritje, përveç të tjerash, lidhet, duke pasur parasysh

specifikat e këtij programi, qe lidhet me mbrojtjen nga zjarri dhe atë civile, te cilat kërkojnë kryerjen e shpenzimeve deri në ditën e fundit të vitit dhe dispozitën e ligjit për zbatimin e buxhetin vjetor, ku çdo shpenzim i pakryer brenda vitit për funksionet, që i janë transferuar pushtetit vendor, trashëgohet në të njëjtin program buxhetor, vitin në vazhdim.

#### 4. Programi Sherbimi i ujitjes dhe kullimit.

##### Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Në këtë program buxhetor bashkia planfikon shpenzime buxhetore për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04240	Sherbimi i Ujitjes dhe kullimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore për punonjesit e sherbimit te ujitjes dhe kullimit.</li> <li>• Shpenzime per mallra dhe sherbime per aktivitetet e ujitjes dhe kullimit.</li> <li>• Shpenzime per mirembajtjen e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit.</li> <li>• Shpenzime per mirembajtjen e automjeteve dhe funksionimin teknologjik te tyre.</li> <li>• Shpenzime per investime per rehabilitimin e digave te rezervuareve dhe rikonstrukcionin e kanaleve ushqyes, vadites dhe kullues, si dhe per blerje mjet transporti.</li> </ul>

Qëllimi përfundimtar i këtij Programi Buxhetor është rritja e zhvillimit ekonomik, bujqësor nëpërmjet administrimit efikas, shfrytëzimit maksimal dhe mirembajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Në funksion të tij janë burimet ujore të 16 rezervuarëve, 14 prej të cilëve janë funksionalë, ku në 11 prej tyre kryhen aktivitete mirëmbajtjeje. Gjithashtu Bashkia disponon një rrjet kanalesh kullues dhe vaditës, përkatësisht 1043km dhe 928 km. Për realizimin e aktiviteteve të këtij Programi buxhetor përgjatë viteve të PBA 2027-2029, krahas burimeve të tjera, janë edhe 7 punonjës të përhershëm dhe 5 të tjerë sezonalë (3M), si edhe dy mjete gërmuese. Nëpërmjet aseteve të cituara më lart, realizohen objektivat bazë, si,

- Përmirësimi i i rrjetit ujites, rrjetit kullues, duke shtuar sipërfaqen bujqësore të mbuluar me shërbimet e ujitjes dhe kullimit.

-Administrimi efikas i rezervave ujore dhe i shërbimit të vaditjes, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i këtyre shërbimeve.

Produktet kryesore që realizohen dhe që thithin pjesën më të madhe të shpenzimeve janë ato të mirëmbajtjes rutinë të kanaleve kulluese dhe ujitëse, si edhe shërbimi i stafit të menaxhimit dhe administrimit dhe monitorimit të burimeve ujore për shërbimin e vaditjes ndaj fermave bujqësore të vogla dhe të mëdha.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 04240 (në SMBV)*

Ecuria e shpenzimeve totale ndër vite pasqyron një nga prioritetet kryesore afatmesëm të Bashkisë, që do realizohet nëpërmjet investimeve të konsiderueshme në këtë program gjatë vitit të pritsëm buxhetor 2026 dhe në vite të tjera të PBA 2027-2029. Investimet, që parashikohen të realizohen përgjatë viteve 2025-2026, për Rehabilitimin e kanalit ujitës nga rezervuari i Pepelit prej 33691 mijë lek dhe Rehabilitimi i Digës së Liqenit të Pepelit prej 95.588 mijë lek (investim i filluar në vitin 2025, brenda saj kontributi i Bashkisë prej 18.353 mijë lek), përfaqësojnë pjesën dërmuese të investimeve për këto periudha, si për ato nga burimet e veta dhe ato nga transfertat e kushtëzuara. Objektivi vazhdon të mbetet **mbeshtetja e fermave bujqësore, por dhe e ekonomive të vogla familjare**, për prodhime dhe rendimend të lartë të kulturave bujqësore, nëpërmjet rehabilitimit pjesor dhe gradual të digave të ujëmbledhësve, kanaleve kryesore ujitëse, si dhe mirëmbajtjes së sistemit të kullimit nëpërmjet fondeve nga Ministria e linjës, nga burimet e Bashkisë, por edhe kontributin e shoqatave dhe fermerëve potencialë të Bashkisë së Dropullit, me synim aktivitetin primar bujqësor në Bashkinë tonë. Në mbështetje të citimit të mësipërm për vitin 2028, është parashikuar blerje e një automjeti 4x4 në shërbim të stafit.

#### 5. Programi 4260. Shërbimi pyjor dhe kullësor.

##### Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për sigurimin e administrimit të çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullësor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullësore. Bashkia siguron mbikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e liçencave për prerje pemësh, si dhe ofrimin e shërbimeve për furnizimin me dru zjarri të popullatës rurale.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04260	Sherbimi pyjor dhe kullësor.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore për punonjësit e shërbimit të pyjeve dhe kullotave.</li> <li>• Shpenzime për mallra dhe shërbime për aktivitetet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të operacioneve pyjore, si dhe shfrytëzimit të kullotave.</li> <li>• Shpenzime për mirëmbajtjen e pyjeve dhe kullotave.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime per prodhimin dhe administrimin e druve te zjarrit per popullaten.</li> <li>• Shpenzime per investime per sistemime dhe vepra malore per mbrojtjen e pyjeve, si dhe per ndertimin dhe rikonstrukcionin e ujembledhesve malore.</li> </ul>
--	--	--

Qëllimi i funksionimit të këtij Programi Buxhetor është shfrytëzimi gjithnjë e më racional i pyjeve dhe kullotave për rritjen e cilësisë së shërbimeve pyjore-kullosore ndaj fermerëve dhe komunitetit në përgjithësi. Bashkia jonë disponon një fond total të sipërfaqes pyjore-kullosore prej 23.000 ha. Numri i punonjësve të këtij Programi në funksion të rruajtjes së fondit të mësipërm, inspektimit dhe monitorimit të tij ka ardhur në rritje, në krahasim me vitet e kaluara dhe ka qëndrueshmëri në vitet e PBA 2027-2029. Realizimi i aktiviteteve në këtë Program ka objektivin për,

- Rritjen dhe konsolidimin e inspektimeve të fondit pyjor dhe kullosor.
- Rritja dhe rehabilitimi i sipërfaqeve pyjore nëpërmjet ripyllëyimeve.
- Rritja e kapacitetit të ekonomisë pyjore-kullosore, nëpërmjet hartimit të planeve të mbarështimit dhe ndërtimit të rezervuarëve malorë.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programi 04260(në SMBV)*

Ecuria e shpenzimeve të përgjithshme të këtij programi për vitin aktual 2026 dhe vitet e tjera të PBA 2027-2029, paraqitet me trend rritës, ku në krahasim me periudhat e kaluara konsiston në rritjen e shpenzimeve për personelin në këtë Program, që lidhet me monitorimin e vazhdueshëm dhe nga afër të gjithë fondit pyjor-kullosor. Kështu shpenzimet totale të këtij Programi rriten nga viti në vit, 115 dhe 127%. Gjithashtu, për periudhën në vazhdim të vitit ushtrimor, do të bëhet pjesë e buxhetit të këtij Programi, Granti i Bazuar në Performancë, me burim financimin e huaj, në vlerë 6.555. mijë lek, përkatësisht 5.888 mijë lek për Plan mbarështimi të ekonomisë pyjore Dropull i Sipërm dhe 667 mijë lek për blerje fidanë pyjorë për gjelbërim. Vazhdohet kjo tendencë edhe për vitet 2027-2029, me hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Pogon dhe investimet për ndërtimin e rezervuarëve malorë për ekonomitë kullosore Ravenjë (Goranxi) dhe Nemerçkë, në vlerë 2.300 mijë lek. Gjithashtu për vitet e PBA 2027-2029 dhe pas kryerjes së planeve të mbarështimit, parashikojme nga burimet e veta 600-800 mije lek shpenzime operative për ripyllëzime për çdo vit, si edhe prodhimin e druve tëzjarrit për popullatën, në vlerë 3.000 mijë lek çdo vit.

#### 6. Programi 04520. Menaxhimi i infrastrukturës rrugore rurale.

##### Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të brendshëm, veprave të artit, sinjalizimin rrugor të trotuareve

dhe shesheve publike vendore si dhe realizon studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimtin e Bashkise.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04520	Menaxhimi i infrastruktures rrugore rurale.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore për punonjesit e shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve rurale.</li> <li>• Shpenzime për mallra dhe shërbime për aktivitetet e mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve të domosdoshme tek akset e rrugëve rurale.</li> <li>• Shpenzime për mirëmbajtjen e veprave të artit të rrugëve rurale.</li> <li>• Shpenzime për hapjen e rrugëve nga Debora, dhe eliminimin e pasojave të fatkeqesive natyrore.</li> <li>• Shpenzime për studime dhe investime për shtrime , asfaltime rikonstruksione dhe ndërtim rrugesh rurale.</li> <li>• Shpenzime për studime dhe investime për rikonstruksionin dhe ndërtimin e veprave të artit në rrugët rurale.</li> </ul>

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale, duke mundësuar akses të plotë të tyre në rrjetin rrugor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe aksesueshmërinë e komunitetit në shërbimet vendore, përbën qëllimin e këtij Programi të rëndësishëm buxhetor. Qëllimi, objektivat, aktivitetet e këtij Programi do të realizohen nëpërmjet burimeve, që janë fuqia punëtore për mirëmbajtje, si edhe mjetet dhe fondet përkatëse për prokurimin e shërbimeve dhe të investimeve. Objektivat e këtij Programi janë:

-Përmirësimi i shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve rurale në gjithë territorin e Bashkisë.

- Ndërhyrje me investime për rikonstruksionin sipas standarteve të perparuara të segmenteve rrugore problematike

-Rritja e mbulimit të shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve dhe cilësinë e këtij shërbimi.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 4520 (në SMBV)*

Duke analizuar shpenzimet në totale të këtij programi buxhetor, vërrejmë një tendencë të rritjes së tyre, si për vitin 2026 dhe vitet e PBA 2027-2029. Kështu rritja nga viti në vit për 27-29, paraqitet 106 dhe 130%. Po kështu, shpenzimet kapitale të këtij programi përbëjnë 52% të totalit të shpenzimeve për investime të Bashkisë për vitin 2026 dhe 80% të totalit të shpenzimeve të

Programit. Kjo e fundit, si rezultat i projektit nderkufitar EXTROVERD ROAD. Gjithashtu, shpenzimet kapitale të këtij programi përbëjnë rreth 36- 52% të totalit të shpenzimeve të Programit për vitet 2027-2029 dhe 25-55% të totalit të investime të Bashkisë. Në fushën e infrastrukturës rrugore përveç vazhdimit të projektit për rikonstruksionin e brendshëm të rrugëve të fshatrave të bashkisë, në vlerë 14.721 mijë lek për vitin 2026, janë edhe projektet EXTROVERD ROAD, si Rikonstruksioni i rrugës Stacioni Pyjor-Ura e Zalos, në vlerë 20.940 mijë lek; Rikonstruksioni dhe Shtrimi me beton i rrugës Ura e Zalos-fshati Hllomo, në vlerë 28.657 mijë lek dhe rikonstruksioni i rrugës në fshatin Bodrishtë 25.743 mijë lek.

Me investimet e realizuara ndër vite dhe ato të parashikuara në këtë program buxhetor, synojmë përqendrimin e tyre në vepra me impakt të pergjithshem, si dhe veprave të tjera të artit të infrastrukturës së brendshme rrugore. Kjo, në lidhje te drejtpërdrejtë me shtimin e shpenzimeve për mirëmbajtje tek rrjeti rrugor egzistues, duke pakësuar në këtë mënyrë copëzimin e shpenzimeve për investime në rrugët brenda fshatrave.

Shpenzimet për investime në veprat e cituara më lart, janë një mënyrë që të ardhurat nga burimet e veta, të arkëtuara, të përdoren në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve vendore, jetës së komunitetit tonë dhe zhvillimit ekonomik lokal.

## 7. Programi 04910. Fondi Rezervë

### Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për fondin rezervë, që është fondi, i cili krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04910	Fondi Rezervë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpenzime korente në artikullin 609, deri në 3% të buxhetit vjetor nga burimet e veta, të cilat transferohen në programe të tjera buxhetore gjatë zbatimit të buxhetit të vitit përkatës.</li> <li>Përdoren për shpenzime për ngjarje të paparashikuara në një ose disa nga programet e shpenzimeve.</li> </ul>

Qëllimi i këtij Programi buxhetor, është përballimi efektiv dhe zvogëlimi i riskut për ngjarje të paparashikuara në buxhetet e programeve të tjera buxhetore dhe që kërkojnë shpenzime shtesë në këto programe, gjatë ushtrimit të funksioneve të Bashkisë.

Si objektiv është hartimi i buxheteve të balancuara dhe zvogëlim të rasteve të përdorimit të Fondit Rezervë në numër, por edhe në vlerë.

### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 04910(në SMBV)*

Për kushtet e Bashkisë tonë, parashikimi i këtij fondi në vlerat, 3457 për vitin 2027 dhe 4.457 për vitet 2028 dhe 2029. Këto përbëjnë rreth 1%, të totalit të shpenzimeve të vitit 2027 dhe 1,3% të viteve 2028 dhe 2029.

Si rezultat i rritjes së performancës së punës, qoftë në hartimin e buxhetit të programeve buxhetore nga ana EMP, po ashtu dhe gjatë zbatimit dhe monitorimit të tyre, parashikohet ulje në përqindje të këtij fondi në krahasim me vitet e mëparshme dhe zvogëlim të numrit të rasteve të përdorimit të këtij fondi nga tre herë gjatë viteve të mëparshme dhe vitit ushtrimor në dy raste për vitet e PBA 2027-2029.

## 8. Programi 04910. Fondi i Kontigjencës.

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për fondin e kontigjencës, që është fondi, i cili krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme për të mbuluar risqet e mundshme të mosrealizimit të të ardhurave, me ndikim në shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit.		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04940	Fondi Rezervë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpenzime korente në artikullin 609, deri në 3% të buxhetit vjetor nga burimet e veta, të cilat transferohen në programe të tjera buxhetore gjatë zbatimit të buxhetit të vitit përkatës.</li> <li>Përdoren për shpenzime të programeve buxhetore, që cënohen nga mosrealizimi i të ardhurave,</li> </ul>

Qëllimi i këtij Programi buxhetor, është minimizimi i risqeve, lidhur me realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë, me ndikim në kryerjen e shpenzimeve në programe të ndryshme buxhetore, gjatë ushtrimit të funksioneve të Bashkisë.

Si objektivi është hartimi i buxheteve të balancuara, sidomos në planifikimin e drejtë të burimeve buxhetore dhe zvogëlim të rasteve të përdorimit të tij si në numër, por edhe në vlerë.

### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 04940 (në SMBV)*

Për kushtet e Bashkisë tonë, parashikimi i këtij fondi në vlerat 2.000 mijë lek për çdo vit të PBA 2027-2029, përbën rreth 0,6%, të totalit të shpenzimeve të PBA.

Si rezultat i rritjes së performancës së punës, qoftë në hartimin e buxhetit të programeve buxhetore nga ana EMP, po ashtu dhe gjatë zbatimit dhe monitorimit të tyre, parashikohet qëndrueshmëri të këtij fondi në krahasim me vitet e mëparshme dhe synohet zvogëlimi i numrit të rasteve të përdorimit të këtij fondi.

## 9. Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve, Reduktimi i ndotjes, Mbrojtja e mjedisit.

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
05100	Menaxhimi i mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;</li> <li>• Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;</li> <li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;</li> <li>• Pastrimi i rrugëve, parqeve etj.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja;</li> <li>• Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes;</li> <li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes;</li> <li>• Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore;</li> <li>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor.</li> <li>• Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore</li> </ul>

Është nga programet më të rëndësishme buxhetore të shërbimeve publike vendore, ku i shërbehet në mënyrë direkte komunitetit të banorëve, biznesit dhe institucioneve. Realizimi i aktiviteteve të këtij Programi, përveçse ka impakt në cilësinë e jetës së banorëve, ndikon në mënyrë të efektshme

në rruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të habitateve natyrore, si edhe zhvillimin ekonomik nëpërmjet krijimit të kushteve të nxitjes dhe promovimit të turizmit në të gjitha format e tij. Qëllimi i këtij Programi buxhetor është përmirësimi dhe menaxhimi efikas i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, por edhe rurale për kushtet e Bashkisë tonë, si edhe pastrimin e rrugëve, shesheve dhe parqeve publike, sidomos qendrat e fshatrave dhe në të dy anët e rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavi.

Pikërisht ky qëllim do të arrihet nëpërmjet objektivave dhe aktiviteteve konkrete, që lidhen me:

-Përmirësimin e grumbullimit, transportimit dhe depozitimit dy herë në javë të mbetjeve urbane, që përfshin edhe trajtimin e mëtejshëm mjedisor në vënddepozitimin e tyre, në rritjen e pikave të grumbullimit nëpër fshatra dhe biznese, si edhe në rritjen e frekuencës javore, sidomos në pikun e qarkullimit dhe aktiviteteve të banorëve të ardhur dhe rezidentë, në periudhën e Gushtit dhe të festave tradicionale në fshatrat tanë Krishtlindjet dhe Pashkët).

-Pastrimi një herë në javë i qendrave të fshatrave, rrugëve qendrore dhe atyre hyrëse Përveç punëtorëve të kualifikuar, në mbështetje të këtij shërbimi janë edhe dy mjete teknologjike, si edhe dy mjete të tjera vetshkarkues, të cilat operojnë jo vetëm në qendrat, por edhe në lagjet e skajshme të fshatrave.

-Aktivitete për promovues për reduktim të trafikut dhe ndotjes, si edhe investime për ndriçim të pastër ekologjik dhe mjedisor në fshatrat e Bashkisë.

Krahas fondeve nga burimet e veta, që përdor Bashkia në këtë program, përdorim duke filluar nga viti 2023, edhe transfertën specifike për këtë qëllim, në kuadër të planit kombëtar për një mjedis të pastër. Kështu për vitin 2026 dhe vitet e tjera të PBA 2027-2029, përveç të ardhurave të arkëtuara nga shërbimi i pastrimit përdoren edhe 9.300 – 9581 mijë lek nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Të gjitha këto, krahas të tjerave, synojnë në mbulimin me këtë shërbim të gjithë teritorit të Bashkisë, edhe në fshatrat më të thella, si edhe në rritjen e familjeve përfituese nga ky shërbim nga viti në vit, por edhe rritjen e sipërfaqeve publike të pastruara. Me rëndësi në këtë drejtim janë edhe aktivitete informuese dhe të ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit urban dhe rural.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 05100 (në SMBV)*

Në këtë program, shikohet se kemi një qëndrueshmëri në rritje të nivelit të shpenzimeve totale për vitet 2027-2029. Brenda totalit të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, veçojmë përsëri rritjen dhe konsolidimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime qysh në vitin e pritshëm buxhetor (2026), që konsistojnë në rritjen e cilësisë së shërbimit sidomos për trajtimin e mbetjeve dhe marrjen e masave për të depozituar në land-file, sipas standarteve duke mbrojtur mjedisin.

Për vitet 2027-2029, nuk kemi planifikuar shpenzime për investime në këtë program, me përjashtim të vitit 2027, që korespondon me mbylljen e projektit evropian GAPs, që trajton ndriçim rrugor të pastër, ekologjik dhe miqësor me mjedisin.

Me interes për vitin aktual, 2026, janë edhe aktivitetet në vazhdim për mbrojtjen e mjedisit, me pjesëmarrjen e Bashkisë edhe në dy projekte me financim të huaj, me fokus reduktimin e zhurmave dhe të ndotjeve, si edhe edukimin për mbledhjen, veçimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike, që janë përkatësisht, ADRION dhe “A Plastic-Free Future for Dropull”.

Rritja e shpenzimeve, çon në rritjen e produkteve të Programit, që konsistojnë në rritjen me 107%, të frekuencës javore të grumbullimit të mbeturinave nga koshat dhe rritjen me 103% të sipërfaqes publike (rrugë dhe sheshe) të pastruara.

## 10. Programi 06260: Shërbimet Publike vendore.

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
06260	Shërbimet publike vendore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin;</li> <li>• Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore;</li> <li>• Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve;</li> <li>• Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;</li> <li>• Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike;</li> <li>• Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike;</li> <li>• Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor.</li> </ul>

Pas Programit të menaxhimit të mbetjeve urbane, është programi i dytë më i rëndësishëm i shërbimeve publike, vendore, ndaj komunitetit, që lidhet me rekreacionin, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese. Me përmirësimet e vazhdueshme të infrastrukturës, është synuar rrijtëzimi i hapësirave publike, sidomos gjelbërimi, mbjellja e luleve, shkurreve dekorativë, si edhe mirëmbajtja dhe trajtimi i trotuarëve në fshatrat, ku ato egzistojnë.

Kështu Qellimi i këtij Programi buxhetor mbetet përmirësimi i mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe shërbimit të ndriçimit publik, me ndikim në sigurinë publike dhe cilësinë e jetës komunitare, që realizohet nëpërmjet objektivave dhe aktiviteteve për:

-Rritjen e sipërfaqes së shesheve dhe hapësirave publike, si sheshet e fshatrave, këndeve të lojrave, parqeve të vogla, trotuarëve dhe varezave publike.

-Rritjen e cilësisë së ndriçimit publik dhe kursimit të energjisë elektrike nëpërmjet instalimit të ndriçuesve dhe aksesoreve të rinj, si edhe atyre me energji të rinovueshme.

-Zgjerim i hapësirave të varezave të fshatrave të Bashkisë.

*PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 06260 (në SMBV)*

Në vitet e PBA 2027-2029, synohet konsolidimi i mëtejshëm i këtij shërbimi me fonde të rritura. Rritja e shpenzimeve në këtë program, do të ndikojë në rritjen e cilësisë së jetës së banorëve

kryesisht ne zonat e vogla rurale dhe mundesinë e gjenerimit të të ardhurave më të shumta në këtë shërbim, nga tarifa e ndriçimit, që për problemet aktuale të demografisë, ka mosrealizime.

Konkretisht, shpenzimet e përgjithshme të këtij programi, parashikohen në rritje, si në krahasim me realizimin e pritshëm 2026, ashtu edhe nga viti në vit për vitet e PBA 2027-2029, nga 13-18%, për vitet 27 dhe 28, që lidhen me investimet për zgjerimin e vareyave të fhatrave, në të tria vitet e PBA dhe vitin aktual, me një masë më të madhe absolute për vitin 2028.

Në fushën e shërbimeve publike, janë parashikuar shpenzime për investime për Rehabilitimin e varezave në fshatrat Llongo, Bularat, Glinë, Grapsh dhe Terihat, si edhe blerje mjetesh mekanike elektrike, si troho, trapano, saldaturë, etj.

Në lidhje me ndriçimin publik, që lidhet drejtpërsëdrejti me sigurinë publike dhe cilësinë e jetës së komunitetit tonë, janë parashikuar shpenzimet kryesore, në të tria vitet e PBA.

Gjithashtu, vazhdimi i kryerjes së shpenzimeve në vitet 2027-2028, do të synojë aktivitete të shtuara për ruajtjen e mjedisit, ndriçimin ekologjik dhe mirëmbajtjen dhe rijetësimin e shesheve të fshatrave.

#### 11. Nënfunksioni 07220: Shërbimet e kujdesit parësor

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor;		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</li> </ul>

Është program buxhetor , që funksionon si i tillë nga viti 2025. Qëllimi i Politikës së këtij Programi për kushtet e Bashkisë tonë, është:

- Edukimi parësor, shëndetësor i komunitetit, nëpërmjet aktiviteteve promovuese.
- Organizimit dhe ngritja e qendrave sociale-shëndetësore në të tria njësitë administrative, si edhe pajisja e tyre me mjetet e duhura për diagnostifikimin dhe kujdesin parësor shëndetësor të komunitetit.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 07220 (në SMBV)*

*Shpenzimet e këtij Programi buxhetor, kanë të bëjnë me përfitimin nga projektet ndërkufitare të Projektit EPIRUS MEDEY, dhe zbatimin e tij përgjatë viteve 2026 dhe 2027, i cili përveç aktiviteteve informuese për shëndetin parësor, përfshin ngritjen dhe funksionimin e qendrave social-shëndetsore, me pajisjet e nevojshme diagnostifikuese dhe lidhjen me qendrat spitalore për trajtim të mëtejshëm. Kështu për vitin 2027, vit i parë i PBA 2027-2029, janë planifikuar për këtë projekt, bashkë me pjesëmarrjen e Bashkisë, në vlerë 13.095 mijë lek.*

## 12. Programi 08220: Shërbime kulturore

Vështrim i përgjithshëm		
Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;</li> <li>Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike;</li> <li>Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e i ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar;</li> <li>Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave;</li> <li>Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.);</li> <li>Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore;</li> <li>Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal.</li> </ul>

Është program buxhetor , që funksionon si i tillë nga viti 2020. Puna dhe eksperiencia e fituar gjatë këtyre viteve, si edhe kualifikimi i vazhdueshëm i stafit të këtij programi, do ti shërbejnë ngritjes së nivelit të aktiviteteve të këtij shërbimi, me synim promovimin dhe aksesueshmërinë e veprave të trashëgimisë kulturore dhe resurseve të tjera turistike, duke rritur ekonomine vendore dhe mireqenien e komunitetit, forcimin e identitetit të veçande të krahinës së Dropullit dhe Pogonit. Si qëllim të këtij Programi Buxhetor, mund të përmëndim gjallërimin e jetës së komunitetit dhe zhvillimin kulturor e sportiv, zhvillimin e turizmit, përmes aktiviteteve, mbrojtjes së trashëgimisë, ruajtjes së traditave, ngjarjeve historike, etj.

Gjithashtu për vitin 2026 dhe vitet e tjera të PBA 2027-2029, planifikojmë shpenzime të rritura materiale, si edhe ato për personelin për aktivitetet e Bibliotekës në Dervician, të Qendrës së Polifonisë në Grapsh dhe muzeun tradicional të prodhimit dhe ruajtjes së djathit.

Objektiv konkret do të jetë përmirësimi i jetës kulturore dhe i aktiviteteve promovuese me fondet e Bashkisë, nëpërmjet:

-Rritjes së numrit të aktiviteteve kulturore , eventeve sportive, njohjen, aksesueshmërinë dhe mirëmbajtjen e monumenteve të kultures dhe të trashëgimisë, etj.

- Rritjen e frekuentimit dhe vizitave në biblioteka, vepra të trashëgimisë kulturore, muze, etj.

*PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 08220 (në SMBV)*

Për vitet 2025, 2026 dhe në vitet në vazhdim të PBA 2027-2029, në këtë Program përfshijmë produktin, Shërbimet e stafit të trashëgimisë kulturore, muzeve, bibliotekave, si edhe promovimin

e trashëgimisë kulturore, duke shpenzuar në total për Programin nga 15.087 – 18.915 mijë lek për çdo vit.

Bashkia në këto vite ka krijuar një traditë pozitive, lidhur edhe me bashkëorganizimin të disa aktiviteteve ndërkombëtare, si festivali i filmit me metrazh të shkurtër DIF (Dropull International Festival), aktivitetet me bashkitë simotra në Greqi, takimet e përvitshme të pogonitëve në të dy anët e kufirit, etj.

Krijimi i Akademisë sportive të Futbollit, Lefter Millo dhe mbështetja me transferta të brendshme fondesh, ka ndikuar në një interesim të lartë të nxënësve të shkollave, por edhe të komunitetit të prindërve dhe më gjerë, duke shfrytëzuar edhe donacione nga aktorë të tjerë për të aktivizuar të rinjtë në edukimin sportiv të komunitetit, si edhe mirëmbajtjen e tereneve sportive, etj.

Përgjatë 2026-ës dhe viteve të PBA 2027-2029, shpenzimet e përgjithshme të këtij Programi buxhetor rriten në mënyrë të ndjeshme në krahasim me periudhat e kaluara, jo vetëm për shtimin dhe gjallërimin e aktiviteteve kulturore-sportive dhe të turizmit si përparësi për zhvillimin ekonomik, por edhe për të mbështetur shoqatat kulturore, që promovojnë vlerat tradicionale dhe historike të komunitetit tonë, për këto të fundit janë parashikuar të shpenzohen 2.800 mijë lek, (brenda tyre dhe Akademia e futbollit “Lefter Millo”).

## 12. Programi 09120: Arsimi bazë dhe parashkollor.

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
09120	Arsimi bazë përfshirë parashkollorin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës;</li> <li>• Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve;</li> <li>• Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve;</li> <li>• Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.</li> </ul>

Qëllimi dhe objektivat e këtij Programi Buxhetor kanë si drejtim frekuentimin gjithnjë e më të lartë të kopshteve, duke krijuar kushte sa më të mira për edukimin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve, nëpërmjet rritjes së shpenzimeve për kushte gjithnjë e më të përmirësuara materiale dhe ato për rritjen e cilësisë së edukimit të fëmijëve në kopshte.

Përgjatë këtyre viteve, krahas trajnimit të vazhdueshëm të edukatoreve, është synuar një mjedis komod dhe didaktik për fëmijët në të dy kopshtet që administron Bashkia, duke rritur nga viti në vit numrin e fëmijëve të akomoduar. Kjo arrihet nëpërmjet rritjes së përqindjes së thithjes së fëmijëve të këtyre grup-moshave dhe përgatitjes së tyre për arsimin fillor.

### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 09120 (në SMBV)*

Qëllimi i këtij Programi është frekuentimi gjithnjë e më i lartë i kopshteve, duke krijuar kushtet për edukimin dhe mbarë vajtjen e fëmijëve. Kjo realizohet nëpërmjet objektivit, që është Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies, që ndikon në rritjen e cilësisë së edukimit të fëmijëve. Për të siguruar një efektivitet më të lartë të shpenzimeve materiale për mallra dhe shërbime në këtë Program buxhetor, nga ana e Bashkisë është gjykuar, që këto lloj shpenzimesh të përqëndrohen tek Programi

tjetër buxhetor i arsimit të mesëm (09230), pasi kushtet demografike përcaktojnë aktivitetin e arsimit, në shkolla të mesme të bashkuara. Prandaj në këtë program për vitet 2027-2029, paraqesim vetëm dhe kryesisht shpenzimet e artikullit 600+601 për paga dhe sigurime shoqërore të edukatoreve dhe të shoqëruesve kujdestare për transportin e fëmijëve në shkolla, në produktin Edukatorë të kualifikuar , të trajnuartë cilat variojnë nga 7.138 – 7317 mijë lek për vitet e PBA 2027-2029.

### 13. Programi 09230: Arsimi parauniversitar.

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore;</li> <li>• Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale;</li> <li>• Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.</li> <li>• Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave;</li> <li>• Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh.</li> </ul>

Si edhe theksuam në programin e mëparshëm buxhetor (09120), vecoria e funksionimit të sistemit arsimor në Bashkinë tone, ku operojmë me Shkollat të Mesme të Bashkuara (pra me një menaxhim drejtues të arsimit bazë dhe të mesëm), krijon ndërthurje të aktiviteteve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes dhe investimeve të përbashkëta në të dyja programet 09120 dhe 09230.

Qëllimi dhe objektivat në këtë Program Buxhetor, përcaktojnë krijimin e kushteve sipas standarteve për një edukim cilësor në rritje të nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. Kjo krahas të tjerave kërkon rritjen e shpenzimeve për kushte gjithnjë e më komode materiale, me ndikim në rritjen e cilësisë së edukimit të nxënësve. Të gjitha këto do të synojnë rritjen e frekuentimit, si dhe rritjen e përqindjes së përthithjes së nxënësve nga shkolla 9-vjeçare në shkollën e mesme.

Me interes dhe ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimit të këtij funksioni është përfundimi përgjatë viteve 2022-2023 i “Rikonstruksionin e Shkolles së Mesme të Bashkuar dhe Kopshtit në fshatin Bularat, të Njësisë Administrative Dropull i Sipërm, si edhe mobilimi i saj, me fonde nga M.Arsimit dhe Sportit, me pjesëmarrje dhe kontribut të Bashkisë në këtë vepër me bashkëfinancim. E njëjta gjë është arritur edhe për Shkollën e Mesme të Bashkuar Dervician, ku është miratuar Rikonstruksioni i saj për vitet 2025-2027, me vlerë 144.345 mijë lek me kontribut nga Bashkia në masën 15%, ose 21.651 mijë lek, (brenda saj, 9.100 mijë lek për vitin 2027), për periudhën e caktuar më lart.

*PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 09230 (në SMBV)*

Krahas shpenzimeve të konsiderueshme për investime në këtë program buxhetor, të cilat i trajtuam më lart, me rëndësi janë edhe shpenzimet e përvitshme për mallra dhe shërbime, shpenzime për mirëmbajtje të godinave shkollore, si dhe krijimin e kushteve, sipas standarteve të përparuara në rang kombëtar, për një mësimdhënie cilësore. Kështu shpenzimet e artikullit 602, për këtë qëllim, si edhe vërrehet nga tabela e mësipërme, për vitin 2026 dhe vitet e PBA 2027-2029, rriten. Në këto shpenzime, krahas atyre të trajtuara më lart, përfshihen edhe shpenzimet për transportimin e nxënësve dhe mësuesve me mjetet e përshtatshme për këtë qëllim nga ana e Bashkisë (pagat dhe shpenzimet materiale). Pikërisht, këto shpenzime kapin vlerat 7.893 – 8.921 mijë lek për vitet e PBA 2027-2029 dhe mbështesin dy produktet, që janë Shërbimet e stafit mbështetës të Arsimit dhe objekte të arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale.

#### 14. Programi 10430: Kujdesi social, familja dhe fëmijët, Të moshuarit, Sëmundjet dhe paaftësia

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
<p>Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes pranë njësive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta</p>		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
10430	Përkujdesi social	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari;</li> <li>• Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;</li> <li>• Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;</li> <li>• Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.);</li> <li>• Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta;</li> <li>• Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje);</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore;</li> <li>• Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;</li> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktimat të dhunës kriminale etj.);</li> <li>• Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira;</li> <li>• Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj;</li> <li>• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar;</li> </ul>
--	--	---

Si fillim, theksojmë se duke filluar nga viti 2020 dhe në vazhdim, nga ana e Bashkisë tonë po punohet sistematikisht për evidentimin e plotë të familjeve dhe individëve në nevojë dhe trajtimin e tyre nga skemat e mbështetjes shoqërore, me fonde të planifikuara nga burimet tona të brendshme. Kështu po te krahasohen te dhenat tregojne se numri i familjeve dhe individeve, që trajtohen dhe planifikohen si të tillë, në vitet në vazhdim me fondet e vet Bashkisë, jane 3-4 herë më të larta, se ato që mbeshteten nga skema kombetare e ndihmës ekonomike.

Permiresimi i cilesise se jetes dhe dinjitetit, te te gjitha kategorive te familjeve dhe individeve në nevoje dhe mbeshtetja me skemat e perkujdesit në harmoni me politikat kombëtare, përbën qëllimin kryesor të këtij Programi Buxhetor, i cili arrihet nëpërmjet objektivave dhe treguesve realë, që kanë të bëjnë me:

-Evidentimin e të gjitha kategorive të familjeve dhe individëve në nevojë dhe përfshirja e tyre në skemat e përkujdesit social.

-Rritjen e përvitshme të përfituesve të personave dhe familjeve në nevojë nga fondi mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike.

-Rritjen e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë, të përfshirë në shërbimet e asistencës sociale në banesë.

- Përfshirjen e gjithë kategorive të përmendura më lart, në programet e rehabilitimit dhe formimit profesional, me synim jetën aktive dhe punësimin.

-Rritjen e kujdesjes sociale për pensionistët e vetmuar dhe në gjëndje të vështirë në qendër rezidenciale.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 10430 (në SMBV)*

Të gjitha aktivitetet e këtij programi, i shërbejnë ecurisë dhe realizimit të tri produkteve bazë, që janë:

- Shërbimi i stafit të Kujdesit Social
- Familje dhe individë në nevojë, që përfitojnë nga skemat e N.E.
- Persona që përfitojnë kujdesin social.

Me përjashtim të produktit të parë, për të cilin shpenzimet janë të pandryshuara gjatë viteve të PBA 2027-2029, shpenzimet që lidhen me dy produktet e tjera, vijnë me rritje nga viti në vit, për produktin e parë në masën 1,6% dhe për të dytin në masën 5,3%.

Me interes në këtë Program është fillimi i implementimit gjatë vitit 2024, të Projektit për Shërbimin lëvizës të Asistencën Sociale në banesë për PAK dhe të moshuar në gjendje të vështirë, i përftuar nga aplikimi në fondin social (MSHMS), në vlerën 6.164 mijë lek, me pjesëmarrje të Bashkisë në 10% të këtij fondi. Për vitet 2025 dhe 2026 pjesëmarrja e Bashkisë rritet përkatësisht, në 40 dhe 70% dhe me përfundimin në vitin 2026, do të kryhet riaplikimi, pasi grupet në nevojë që mbështet dhe aktiviteti i këtij Programi, janë jetësore.

Duke analizuar te dhenat ne tabelën e të dhënave bazë (SMBV), për këtë Program Buxhetor, mund të dallojmë rritjen e numrit te familjeve dhe individeve ne nevoje, sidomos i te moshuarve te vetmuar dhe te braktisur, qe nuk mund ti sherbejne vetes, të cilët kerkojne krahas masave per trajtimin modest financiar edhe ndertimin dhe funksionimin e shtepise se te moshuarve prane Bashkise tone dhe te qendrave ditore te bashkerenduara me kujdes mjekesor dhe sanitar prane baneses se tyre, investime te cilat parashikohen te realizohen nga burimet e brendshme të Bashkisë dhe synojnë ndërtimin dhe funksionimin e Qendrës së të moshuarve, në fshatin Dhuvian, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm, në vlerë 31.873 mijë lek përgjatë viteve 2026-2027 dhe mobilimin e saj , në vlerë 11.509 mijë lek , përgjatë vitit 2028.

#### 15. Programi 10661: Strehimi Social

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
10661	Strehimi social	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;</li> <li>• Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</li> <li>• Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;</li> <li>• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit;</li> <li>• Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;</li> <li>• Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabel me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;</li> </ul>

Është program i ri për Bashkinë tone, që ka filluar të funksionojë gjatë vitit 2023, me aplikimin që është bërë në thirrjen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, për programet e strehimit social, ku qëllimi primar është evidentimi i situatës së nevojave më imediate për strehim social dhe më pas kryerjen e shpenzimeve për investime për përmirësimin e kushteve të banimit të familjeve dhe individëve në nevojë, kryesisht persona me aftësi të kufizuara dhe ata që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Këto investime do të realizohen nëpërmjet aplikimit në programet sociale të strehimit, në bazë të planit pesëvjeçar, social të strehimit, të miratuar nga Këshilli i Bashkisë për periudhën 2023-2028. Qëllimi afatgjatë është trajtimi dhe dhënia e zgjidhjeve nëpërmjet programeve të strehimit social, gjithë kërkesave nga grupet në nevojë, duke aksesuar fillimisht projektin e përmirësimit të kushteve të banimit në komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara, ku janë edhe nevojat me të mëdha, duke vazhduar me programin e strehëzave me adaptim objekti administrativ gjatë vitit 2026, duke rritur nga viti në vit përfituesit nga ky projekt.

#### *PBA 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 10661 (në SMBV)*

Vlerat e investimeve të paraqitura në tabelë, për vitet 2027-2029, prej 1.200 mijë lek, janë pjesa e bashkëfinancimit të Bashkisë (30%) në këto projekte strehimi social, që do aplikohen gjatë viteve të PBA 2027-2029, të cilat konsistojnë në përmirësimin dhe krijimin e kushteve të banimit për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara, përkatësisht për 6-10 familje në nevojë, sipas Planit të Strehimit Social.

## Treguesit Financiarë.

Nr	Emertimi	Njesia e metjes	VITET						
			2024	2025	2026	2026 i rishikuar	2027	2028	2029
1	Shpenzime te pergjithshme/te ardhura te pergjithshme	%	83,5	70,5	100	100	100	100	100
2	Te ardhurat, burimet e veta/ transferta qendrore	%	27,6	22,2	30,3	30,3	28,6	27,5	26,5
3	Te ardhurat burimet e veta/te ardhura te pergjithshme	%	17,4	15	15,3	13,2	19,7	20,2	19,6
4	Realizimi i buxhetit plan/ fakt	%	84,9	68,2	x	x	x	x	x
5	Realizimi i shpenzimeve per investime Plan/ Fakt	%	83,6	39	x	x	x	x	x
6	Shpenzime kapitale/ Shpenzime te pergjithshme	%	25,2	10,7	17	20,3	14	13,5	12,6
7	Shpenzime korrente/shpenz te pergjithshme	%	21,9	22,8	21	19,7	22,4	25,8	27,4
8	Shpenzime personeli/Shpenzime te pergjithshme	%	52,8	66,4	42	39,3	58,7	60,5	60
9	Shpenzime politika sociale/shp te pergjithshme	%	3,5	5,5	4,62	6,64	10,46	8,8	7,4
10	Detyrime te prapambetura/Totali i te ardhurave	%	1,5	0	x	x	x	x	x

V.O: Në treguesin 9 , janë llogaritur vetëm shpenzimet nga burimet e vetë Bashkisë, pa përfshirë ato nga MSHMS.

Nga vlerësimi i treguesve financiarë të mësipërm, arrijmë në përfundimin se Bashkia ka një qëndrueshmëri financiare të konsoliduar, si për vitet e mëparshme 2024, 2025, vitin aktual 2026, ashtu edhe për vitet e PBA 2027-2029. Përsa i përket të ardhurave, vërrejmë se të ardhurat nga burimet e veta, në raport me të ardhurat totale nga të gjitha burimet kanë trend rritës. Përsa i përket realizimit të shpenzimeve të periudhave të mëparshme, edhe ato kanë qëndrueshmëri në nivele të kënaqshme, rreth 85%, për vitin 2024, por 68,2% për vitin 2025, për shkak të lidhjes së vonët të kontratave për investimet dhe mosrealizimit të tyre brenda 2025, duke mbetur si të trashëguara për

vitin 2026, që po realizohen me ritme të shpejta. Në lidhje me strukturën e shpenzimeve, sipas klasifikimit ekonomik, vërrejmë një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve për Personelin dhe atyre korente të tjera në vitin 2025, (66,4%), Ulje të planifikuar të tyre për vitin 2026, (42%), për shkak të investimeve të larta, si nga burimet tona dhe ato të huaja dhe stabilizim të tyre për vitet e PBA 2027-2029, në vlerat 58,7 – 60%). Kjo, veç të tjerash, lidhet me politikat kombëtare për rritjen e pagave dhe të efektivitetit në punë. Ndërsa në lidhje me shpenzimet për investime (kapitale), vërrejmë një ulje të tyre, ndaj shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2025, në krahasim me vitin e mëparshëm 2024, për shkak të mosrealizimit të tyre, që e përmëndëm më lart, por qëndrueshmëri për vitet e PBA 2027-2029. Gjithashtu kemi trend rritës domethënës të shpenzimeve për politika sociale në vitin 2026 dhe vitet në vazhdim 2027-2029, ndaj shpenzimeve të përgjithshme, krahasuar me periudhat e mëparshme 2024 dhe 2025, që varriion nga 6,6% në vitin 2026, në 10,46-7,4%, në vitet 2027-2029.

### **Detyrime te prapambetura.**

Aktualisht, në këtë fazë te realizimit te pritshëm te buxhetit te vitit 2025, detyrimet e prapambetura në bazë të formatit “Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare”, te raportuara në 4-mujorin, (Janar-Prill 2026), që dërgojmë në MFE, janë 000 lek, që përbëjnë “0”%, të totalit të shpenzimeve faktike nga burimet e veta, të vitit 2025.

### **Rreziqet financiare dhe fiskale.**

Buxhetet e te tria viteve, ne kuader të PBA 2027-2029, janë të ballancuara dhe të gjitha angazhimet dhe objektivat e ndërmarra nga ana e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të Bashkisë tonë (Kryetari dhe Këshilli Bashkiak), jane brenda mundësive të burimeve të financimit. Buxhetimi i të ardhurave, si për vitin aktual, ashtu edhe për vitet e PBA 2027-2029, ka për bazë arritjet dhe eksperiencën e viteve të kaluara, si dhe trendin e zhvillimit lokal, rajonal dhe kombëtar. Bashkia jonë nuk paraqet veshitirësi financiare dhe as rezik per tu ndodhur ne kushtet e veshitirësisë financiare. Nuk kemi detyrime të prapambetura të pashlyera, të pabuxhetuara, të cilat mund të çënojnë nivelin aktual dhe të ardhshem të shpenzimeve, me ndikim në sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për komunitetin tonë.

Konceptoi: K.LENGO

Miratoi : S.RAPI

Pranoi : P.DHEFTO

**KRYETARI**  
**Dhimitraq TOLI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA DROPULL**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT VENDIM**

**NR., DATË. 06.2026**

**PËR**

**“MIRATIMIN E PËRFITUESVE DHE MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR TË NDIHMËS EKONOMIKE, PËR MUAJI QERSHOR 2026”.**

Në mbështetje të nenit 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Ligji 139/2015, “Mbivetqeverisjen vendore”, nenit 21, të Ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, indryshuar, VKMnr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, indryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68 date 17.12.2025, “Përmiratimin e kriterëve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët nënevojë, për vitin 2026”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68, dt.17.12.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

1. Miratimin e listës së përfituesve dhe masës mujore të përfitimit nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët nënevojë, për muajin Qershor 2026, sipas tabelave bashkangjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe e Strehimit për zbatimin e këtij vendimi..
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 ,pika 6 te ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

**KRYETAR**  
**Donika BAUÇI**